



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË  
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL  
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË  
MËSUESVE TË QYTETARISË**

**SHKURT 2024**

**Koordinatore**

**Astrit Dautaj**

## 1. HYRJE

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të **qytetarisë** është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së qytetarisë në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorive të kualifikimit, si dhe të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MAS-it ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumente zyrtare<sup>1</sup>, të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve;
- programi i lëndës;
- aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë në mësimdhënie;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja e lëndës qytetari.

## 2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së qytetarisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të, përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;

---

<sup>1</sup> Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- të ofrojë një program të detyruar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

### **Programi synon që mësuesi:**

- të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- të rritë përgjegjshmërinë për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- të rritë aftësitë dhe kompetencat profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor, drejt një mësimdhënieje të suksesshme;
- të rritë përgjegjshmërinë për njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të rritë përgjegjshmërinë për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të rritë aftësitë në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes.
- të realizojë në praktikë, nëpërmjet demonstrimit konkret, aftësitë e fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

### **Objektivat afatshkurtër e programit**

Programi synon që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor dhe veçanërisht rrisitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat bazuar në standardet profesionale të mësuesit për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të zotërojë konceptin e gjithë përfshirjes dhe të mundësojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;

- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e metodave për menaxhimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të reja të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësiive shkencore të lëndës, si dhe zbatimin e tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe veçoritë e klasave ku japin mësim;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tij në shkollë;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca.

### **3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të ekonomisë është strukturuar sipas fushave kryesore të përmendura më sipër të zhvillimit profesional, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së qytetarisë që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke pasur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit, si dhe në standardet e mësuesit të lëndës së qytetarisë. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhet me secilën fushë/lëndë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive, si dhe literatura përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

<b>PËRMBAJTJA E PROGRAMIT</b>
<b>Fusha: Dokumentacioni Zyrtar Shkollor</b>

<p style="text-align: center;"><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Mësuesi:</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Literatura</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe Rregulloren për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;</li> <li>• demonstron zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies;</li> <li>• zbaton etikën profesionale të mësuesit.</li> <li>• respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit.</li> <li>• respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>• zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li> <li>• Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020.</li> <li>• Udhëzimi nr.22 “Për fillimin e vitit shkollor 2022-2023 në sistemin arsimor parauniversitar”, MAS (27.07 2022).</li> <li>• Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar me Udhëzimin nr.14, date 28.7.2021 .</li> <li>• Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> <li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe</li> </ul>

	të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.
<b>Fusha: Programet lëndore</b>	
<b>Rezultatet e pritshme</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë:</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përcaktojë çfarë mësuesit duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë për nxënësit;</li> <li>• të analizojë karakterin konkret dhe të qartë të përmbajtjes së kurrikulës;</li> <li>• të vlerësojë zbatimin cilësor të programit: kërkesat ndaj mësuesit si zbatues i programit lëndor;</li> <li>• të vërë në dukje të rishikimi i programit lëndor: kërkesat ndaj mësuesit si nismëtar i ndryshimit ose përmirësimit të programit lëndor;</li> <li>• të dallojë strukturën e programit lëndor dhe të përshkruajë përmbajtjen e rubrikave të saj;</li> <li>• të përshkruajë lidhjet ndërmjet njohurive të lëndës që jep mësim me njohuritë e disiplinave të tjera që zhvillohen në shkollë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza kurrikulare, 2014.</li> <li>• Programi i lëndës qytetari për gjimnazin, për arsimin profesional dhe për arsimin e orientuar (social – kulturor).</li> <li>• Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016.</li> <li>• Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat X-XII.</li> </ul>

<b>Fusha : Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie</b>	
<b>Rezultatet e pritshme</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë:</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të zhvillojë mësimdhënie në përshtatje me synimet dhe objektivat konkrete të lëndës që jep;</li> <li>• të zhvillojë koncepte dhe metoda që e bëjnë nxënësin të aftë për të zbatuar njohuritë e reja;</li> <li>• të jetë i hapur për bashkëpunim dhe vlerësim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.</li> <li>• Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017.</li> <li>• Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016.</li> </ul>

<p>të punës që bën;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallojë pyetjet e hapura dhe të mbyllura, të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar;</li> <li>• të hartojë objektiva të nxënit;</li> <li>• të dallojë dhe të hartojë objektiva arritjeje në nivele të ndryshme;</li> <li>• të zbatojë njohuritë e tij për krijimin e një klime të përshtatshme të mësuarit në klasë;</li> <li>• të dallojë dhe të përzgjedhë metoda dhe teknika të përshtatshme me objektivat e të mësuarit dhe stilet e ndryshme të të mësuarit;</li> <li>• të strukturojë një ditari dhe të tregojë qëllimin e rubrikave të tij;</li> <li>• të përcaktojë synimet ose objektivat e kurrikulës në përputhje me filozofinë arsimore të përzgjedhur;</li> <li>• të alternojë metodat e punës individuale dhe asaj në grup në varësi të objektivave të të mësuarit;</li> <li>• të zbatojë teknika dhe forma të ndryshme të vlerësimit të nxënit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA 2016.</li> <li>• Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, ASCAP (ish IZHA) 2018.</li> <li>• Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021.</li> <li>• Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021.</li> <li>• Materiale ndihmëse për edukimin qytetar <a href="https://www.ascap.edu.al/materiale-ndihmese-per-edukimin-qytetar-2/">https://www.ascap.edu.al/materiale-ndihmese-per-edukimin-qytetar-2/</a></li> </ul> <p style="text-align: center;">Demokracia ne veprim</p> <p><a href="https://www.living-democracy.al/textbooks/volume-1/">https://www.living-democracy.al/textbooks/volume-1/</a></p> <p>Vëllimi 1</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kushtet e mësimdhënies dhe të të mësuarit (faqe 60-64).</li> <li>- Vendosja e objektivave dhe përzgjedhja e materialeve (faqe 65-72).</li> <li>- Drejtimi i procesit të të nxënit dhe përzgjedhja e formave të mësimdhënies (faqe 81-82, 87-88, 90-92).</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Manuali për edukimin e qytetarisë digjitale i Këshillit të Evropës.</li> </ul> <p>Materiale ndihmëse për edukimin qytetar <a href="https://www.ascap.edu.al/materiale-ndihmese-per-edukimin-qytetar-2/">https://www.ascap.edu.al/materiale-ndihmese-per-edukimin-qytetar-2/</a> faqe 11-15.</p>
--	--

<b>Fusha: Aspekte të etikës dhe komunikimit</b>	
<b>Rezultatet e pritshme</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë:</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>të përshkruajë parimet themelore mbi të cilat është hartuar kodi i etikës së mësuesit;</li> <li>të dallojë sjelljet e mësuesit që burojnë nga parimet themelore;</li> <li>të hartojë vetë një kod të thjeshtë sjelljeje që bazohet në parimet dhe standardet e kodit të etikës;</li> <li>të përshkruajë sjelljet model që duhet të karakterizojnë zbatuesit e kodit të etikës së mësuesit, në varësi të funksionit që ka në komunitetin e shkollës;</li> <li>të marrë vendime në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin, gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> <li>Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020.</li> <li>Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”</li> </ul>
<b>Fusha: Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe</b>	
<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë:</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>të zbatojë rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe standarde.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>
<b>Fusha : Përmbajtja shkencore e lëndës</b>	
<b>Qytetaria 6-9</b>	
<b>Klasa 6</b>	



Nr.	Tematika	Rezultatet e pritshme	Literatura
	<b>Komuniteti</b>	<b>Mësuesi të jetë i aftë:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallojë përgjegjësinë e pushtetit vendor në kryerjen e shërbimeve në dobi të komunitetit si: shërbimet publike, rendi dhe qetësia publike, mirëmbajtja dhe mbrojtja e mjedisit etj.;</li> <li>• të identifikojë raste kur pushteti vendor nuk ika kryer si duhet detyrat e tij ndaj komunitetit;</li> <li>• të përcaktojë shërbimet komunitare, në të cilat roli i qytetarëve është shumë i rëndësishëm;</li> <li>• të dallojë përgjegjësitë e qytetarëve në shërbim të komunitetit, në varësi të llojit të shërbimit;</li> <li>• të shpjegojë arsyet e pjesëmarrjes të tyre së ulët në shërbim të komunitetit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetaria për klasën 6-9</li> </ul>
	<b>Kultura</b>	<b>Rezultatet e pritshme</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• të lidhë pikëpamjet e tiparet e ndryshme që janë karakteristikë e disa grupeve me përkatësinë e tyre kulturore;</li> <li>• të përshkruajë se si njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore, me këndvështrime dhe pikënisje të ndryshme interpretojnë informacionet dhe përvojat;</li> <li>• të dallojë dhe të përshkruajë shembuj të reagimit të ndryshëm të individëve ose grupeve të ndryshme ndaj dukurive të ndryshme etj., mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre;</li> <li>• të dallojë raste konfliktesh që shkaktohen nga qëndrimet e ndryshme që njerëz nga kultura ose nënkultura të ndryshme mbajnë ndaj të njëjtës sjellje ose dukuri;</li> <li>• të shpjegojë se njerëzit nga kultura të ndryshme, janë të ngjashëm në shumë aspekte të rëndësishme, si qenie njerëzore që gëzojnë të njëjtat të drejta pavarësisht.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•</li> </ul>
	<b>Tregu global</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të shpjegojë pse vendet zhvillojnë tregti me njëri-tjetrin;</li> <li>• të identifikojë interesat, tarifatat, subvencionet, embargot dhe standardet si pengesa tregtare që qeveritë përdorin për të kontrolluar tregtinë dhe për të rritur përfitimet për vendet e tyre;</li> </ul>	

		<ul style="list-style-type: none"> <li>të përshkruajë rolin e Organizatës Botërore të Tregtisë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare ndërmjet shteteve;</li> <li>të shpjegojë si aspektet kulturore të një biznesi ndryshojnë nga njeri vend në tjetrin;</li> <li>të shpjegojë tregtinë globale dhe emigrimin si mjete të shkëmbimit ndërkombëtar të burimeve njerëzore;</li> <li>të përshkruajë si përmirësimet në teknologji dhe në transport dhe shkëmbimi i ideve kanë ndikuar në rrjedhën e informacionit dhe në rritjen e rendimentit;</li> <li>të shpjegojë përse tregtia ndërkombëtare kërkon shkëmbimin e monedhave;</li> <li>të argumentojë përse vendet mund të mbështesin ose të kundërshtojnë vendosjen e një monedhe të përbashkët.</li> </ul>	
<b>Klasa e shtatë</b>			
	<b>Rregullat dhe roli i tyre në shoqëri</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>të përshkruajë përmbajtjen e koncepteve; ligje, rregulla dhe zakone;</li> <li>të analizojë vlerat (morale, politike e shoqërore etj.) që shërbejnë si burim për ligjet;</li> <li>të shpjegojë ndikimin e ligjit në jetën personale dhe shoqërore;</li> <li>të vlerësojë rolin e gjykatave, të policisë dhe të qytetarëve në zbatimin e ligjit;</li> <li>të analizojë faktorët që çojnë në ndryshime ligjit.</li> </ul>	
	<b>Të drejtat e njeriut</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>të dallojë dhe përshkruan përmbajtjen e të drejtave të njeriut;</li> <li>të tregojë nga burojnë të drejtat e njeriut;</li> <li>të listojë dokumentet kryesore ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut;</li> <li>të shpjegojë rëndësinë individuale dhe shoqërore të të drejtave personale, ekonomike dhe politike, si dhe lidhjen ndërmjet tyre.</li> </ul>	•
	<b>Përgjegjësitë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>të shpjegojë se cilat janë përgjegjësitë qytetare;</li> <li>të kategorizojë përgjegjësitë e tyre personale dhe shoqërore në komunitet;</li> </ul>	•

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• të analizojë burimet e përgjegjësive;</li> <li>• të vlerësojë rëndësinë individuale dhe shoqërore të plotësisht të përgjegjësive dhe të analizojë shkaqet dhe pasojat në rast mosplotësimi.</li> </ul>	
	<b>Pjesëmarrja qytetare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë konceptin qytetari, pjesëmarrje qytetare dhe shoqëri civile;</li> <li>• të identifikojë veprimin e parimeve themelore të qeverisjes demokratike në jetën e komunitetit në qytetin dhe vendin tonë;</li> <li>• të përshkruajë ndikimin e formave të ndryshme të opinionit shoqëror në veprimtarinë e qeverisë;</li> <li>• të përshkruajë përgjegjësitë e qeverisë ndaj qytetarëve dhe anasjelltas;</li> <li>• të shpjegojë ndikimin e veprimit qytetar në formulimin e politikave publike dhe marrjen e vendimeve.</li> </ul>	•
	<b>Ekonomi për sukses</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të identifikojë lidhjet ndërmjet vendosjes së qëllimeve, financave vetjake, arsimit dhe karrierës;</li> <li>• të tregojë rëndësinë e një buxheti të balancuar për të gjithë punëtorët;</li> <li>• të përcaktojë termin “të ardhura” dhe bën dallimin ndërmjet konceptit “e ardhur neto” dhe “e ardhur bruto”;</li> <li>• të tregojë rrugët për balancimin e buxhetit;</li> <li>• të identifikojë ndryshimin ndërmjet kartës së debitit dhe kartës së kreditit;</li> <li>• të përshkruajë pasojat e favorshme dhe të pafavorshme të pikëve të ulta dhe të larta të kredit (besueshmëria e kreditimit);</li> <li>• të shpjegojë veprimet që shkaktojnë uljen dhe rritjen e besueshmërisë së kreditorit;</li> <li>• të shpjegojë se si sigurimi është një mjet për të pakësuar rrezikun e mundshëm financiar.</li> </ul>	•
<b>Klasa e tetë</b>			
	<b>Unë dhe të tjerët</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të tregojë që njerëzit ndryshojnë nga njëri-tjetri në drejtime të ndryshme, por ata ndajnë shumë gjëra të përbashkëta;</li> <li>• të identifikojë disa nga interesat e përbashkëta që kanë me anëtarët e komunitetit, pavarësisht nga</li> </ul>	•

		<p>ndryshimet që kanë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë mundësitë dhe kufizimet e një personi në plan individual për plotësimin e interesave e ëndrrave vetjake dhe nevojën që ka për të tjerët;</li> <li>• të përshkruajë dhe të shpjegojë se si njerëzit kanë nevojë për njëri-tjetrin në nivelin: <ul style="list-style-type: none"> <li>- vetjak,</li> <li>- familjar,</li> <li>- e grupit shoqëror,</li> <li>- e lagjes etj.;</li> </ul> </li> <li>• të përshkruajë marrëdhëniet e ndërvarësisë gjatë jetës së tij;</li> <li>• të parashikojë mundësinë e ndërvarësisë në të ardhmen, duke u bazuar në studimin e së kaluarës dhe në zbulimin e prirjeve të sotme;</li> <li>• të tregojë çfarë mund të bëjnë ata sot në mënyrë që të sjellin të ardhmen e dëshiruar ose të frenojnë të ardhmen e padëshiruar.</li> </ul>	
	<b>Ne dhe Evropa</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallojë disa nga tiparet e identitetit kombëtar;</li> <li>• të dallojë tiparet e identitetit evropian (eksplorimi i Evropës);</li> <li>• të përshkruajë tipare, ide, qëndrime që janë të veçanta për kulturën tonë krahasuar me ato të kulturave të tjera;</li> <li>• të përshkruajë anët pozitive dhe negative të të qenit vetëm shqiptar,</li> <li>• të lidhë përgjegjësitë si shqiptar me ato të qenit qytetar i Evropës.</li> </ul>	•
	<b>Shqipëria dhe Evropa</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë rolin dhe qëllimet themelore të organizmave të tillë evropianë si: Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian etj.;</li> <li>• të tregojë, duke përdorur shembuj të ndryshëm, ndikimin pozitiv ose negativ të bashkëpunimit të Shqipërisë me Evropën ose me gjerë, në jetën e individit, të familjes, të ekonomisë dhe të kombit shqiptar.</li> </ul>	
	<b>Ne dhe problemet globale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të evidentojë format e shfaqjes së problemeve globale, si: ndotja e mjedisit, ruajtja e burimeve natyrore etj. në vendin tonë;</li> <li>• të analizojë shkaqet dhe pasojat që sjellin këto probleme në bashkësinë e tyre, në Shqipëri dhe më gjerë.</li> </ul>	
	<b>Është e</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të tregojë që zgjedhjet e bëra në arsimin bazë mund të ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e sotme</li> </ul>	

	<b>ardhmja ime</b>	<p>dhe të ardhme;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të shqyrtojë grupimet e profesioneve dhe të eksplorojë më tej profesionin/profesionet brenda çdo grupimi që janë në interes të tij;</li> <li>• të përshkruajë ndërvarësinë dhe vlerën e të gjitha llojeve të punëve (profesioneve);</li> <li>• të përshkruajë faktorët themelorë që duhet të merren parasysh në zgjedhjen e një pune (profesioni);</li> <li>• të përshkruajë industrinë që parashikohen të rriten me ritme të larta;</li> <li>• të identifikojë aftësitë për punë të zhvilluara nga përvojat dhe veprimtaritë e mëparshme;</li> <li>• të përshkruajë mjetet kryesore të kërkimit të një pune, duke përfshirë këtu edhe aplikimet për punë, CV, rekomandimet dhe intervistat;</li> <li>• të përshkruajë aftësitë e përgjithshme vetjake që zotëron dhe ato që ka nevojë t'i ushtrojë.</li> </ul>	
<b>Klasa e nëntë</b>			
	<b>Ç 'është demokracia?</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përkufizojë me fjalët e tij konceptet e ndryshme për demokracinë;</li> <li>• të dallojë demokracinë e drejtpërdrejtë nga demokracia e përfaqësuar dhe të listojë karakteristikat kryesore të tyre;</li> <li>• të dallojë argumentet që mbështesin nga ata që i kundërvihen demokracisë;</li> <li>• të dallojë dhe të përshkruajë elemente dhe praktika të demokracisë në bashkësinë ku jeton, në shtëpi, në klasë, në lagje dhe në realitetin shqiptar.</li> </ul>	•
	<b>Faktorët që ndihmojnë dhe pengojnë demokracinë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përcaktojë disa nga faktorët që mbështesin dhe të atyre që pengojnë demokracinë;</li> <li>• të identifikojë faktorë që mbështesin dhe pengojnë demokracinë në klasë, shkollë, lagje, vend;</li> <li>• të identifikojë faktorët që ushqejnë lindjen dhe veprimin e faktorëve që mbështesin dhe të atyre që rrezikojnë demokracinë në Shqipëri;</li> <li>• të japë një përcaktim lidhur me tiparet e realitetit në Shqipëri që mund të rrezikojnë demokracinë.</li> </ul>	•
	<b>Funksionimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë disa nga çështjet që duhet të zgjidhë demokracia në përgjithësi dhe</li> </ul>	•

	<b>i demokracisë</b>	<p>demokracia shqiptare në mënyrë të veçantë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë rolin e institucioneve demokratike;</li> <li>• të përshkruajë strukturën e qeverisjes në një demokraci dhe detyrat kryesore të tri degëve të pushtetit;</li> <li>• të dallojë elemente demokratike ose jodemokratike në funksionimin e pushtetit dhe të degëve të ndryshme të tij në Shqipëri;</li> <li>• të identifikojë faktorë të ndryshëm ekonomikë, shoqërorë, politikë etj., që ndikojnë në cilësinë e funksionimit të pushtetit demokratik në Shqipëri;</li> <li>• të tregojë cili duhet të jetë roli i individëve në demokraci dhe gjykon për rolin e individëve në shoqërinë shqiptare në drejtim të zhvillimitose pengimit të proceseve demokratike;</li> <li>• të përshkruajë rolin e partive politike në demokraci dhe marrëdhëniet e tyre me interesat e individëve që organizohen në parti;</li> <li>• të përshkruajë rolin e zgjedhjeve dhe të votimit në një demokraci.</li> </ul>	
	<b>Pjesëmarrja qytetare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përshkruajë disa nga rrugët e realizimit të pjesëmarrjes qytetare në demokraci;</li> <li>• të tregojë mundësitë dhe rrugët e rritjes së pjesëmarrjes qytetare në realitetin ku jetojnë (lagje, shkollë, fshat, qytet etj.);</li> <li>• të identifikojë probleme për zgjidhje në mjedisin, ku jetojnë dhe formulon e paraqet politikën publike për zgjidhjen e tyre.</li> </ul>	•
<b>Qytetaria 10</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Tematika</b>	<b>Rezultatet e pritshme</b>	<b>Literatura</b>
1	Ligji dhe nenet	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të shpjegojë qëllimin e ligjit;</li> <li>• të analizojë funksionet e ligjit në shoqëri;</li> <li>• të identifikojë pasojat e veprimit apo mosveprimit të ligjit në shoqëri;</li> <li>• të identifikojë vlerat që qëndrojnë në themel të ligjeve;</li> <li>• të shpjegojë domosdoshmërinë e llojeve të</li> </ul>	<p>Tekste për nxënësin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetaria për klasën 6-9</li> <li>• Qytetaria për klasën 10</li> </ul>

		<p>ndryshme të ligjit në shoqëri;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të evidentojë dhe analizojë faktorët që ndikojnë në qëndrimin e tij ndaj zbatimit të ligjit.</li> </ul>
2	Kushtetuta e Shqipërisë dhe të drejtat e njeriut	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të përshkruajë parimet kryesore të mishëruara në kushtetutën shqiptare;</li> <li>të argumentojë rëndësinë e mbështetjes në parimet e kushtetutës për hartimin dhe zbatimin e ligjeve;</li> <li>të argumentojë domosdoshmërinë dhe rëndësinë e përmirësimit të kushtetutës në përputhje me dinamizmin dhe veçoritë e jetës ekonomike, sociale e politike të shoqërisë.</li> </ul>
3	Familja	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të përshkruajë evolucionin historik të familjes;</li> <li>të përshkruajë funksionet kryesore të familjes;</li> <li>të dallojë lidhjet që ekzistojnë ndërmjet zhvillimit demografik dhe plakjes së popullsisë;</li> <li>të përshkruajë disa nga problemet e familjes së sotme.</li> </ul>
4	Shkolla	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të argumentojë rëndësinë e mbrojtjes me ligj të së drejtës për arsimim;</li> <li>të përshkruajë ndryshimet e shkollës në vite;</li> <li>të përshkruajë mundësitë që ofron arsimimi në shkollë;</li> <li>të dallojë rolin e shkollës dhe të mësuesve;</li> <li>të tregojë disa nga problemet me të cilat përballet arsimit dhe shkolla jonë sot.</li> </ul>
5	Fëmijëria	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të japë përcaktimin ligjor të termit <i>fëmijë</i>;</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë përgjegjësinë civile dhe penale të fëmijëve sipas ligjit shqiptar;</li> <li>• të përshkruajë ligjet shqiptare që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët.</li> </ul>
6	Rritja e fëmijës, ndryshimet	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë disa nga ndryshimet fizike dhe psikologjike që pëson para adoleshencës (10-14 vjeç);</li> <li>• të rendisë disa nga problemet me të cilat përballet në jetën e përditshme me bashkëmoshatarët dhe të rriturit;</li> <li>• të dallojë disa nga arsyet pse të rriturit dhe fëmijët kanë pikëpamje të ndryshme.</li> </ul>
7	Puna	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të japë një përcaktim të termave <i>punë</i> dhe <i>punoj</i>;</li> <li>• të rendisë lloje të ndryshme punësh;</li> <li>• të rendisë të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve sipas legjislacionit shqiptar për punën;</li> <li>• të rendisë disa nga hapat e domosdoshëm për të kërkuar punë;</li> <li>• të përshkruajë tablonë e disa prej ndryshimeve kryesore që ka pësuar bota e punës në shoqërinë shqiptare dhe pasojat e tyre për botën e punës në Shqipëri;</li> <li>• të përshkruajë disa nga tiparet kryesore të botës së punës në Evropë dhe kërkesat që shtron ajo për të rinjtë shqiptarë, që dëshirojnë të jetojnë në të;</li> <li>• të parashikojë pasoja në aspekte të ndryshme të jetës së fëmijës, qëndrime ose praktika të caktuara, që lidhen me punën e fëmijëve në familje ose në</li> </ul>



		shoqëri.
8	Mjedisi	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallojë rreziqet me të cilat përballlet sot planeti ynë;</li> <li>• të rendisë disa prej angazhimeve ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit;</li> <li>• të rendisë pasojat që ka prishja e ekuilibrave ekologjikë për planetin dhe jetën e njeriut dhe të parashikojë disa nga pasojat që kanë për brezat e ardhshëm zgjedhjet që bëjnë individët, grupet ose shteti;</li> <li>• të përshkruajë detyrimet ligjore të shtetit shqiptar për mbrojtjen e mjedisit;</li> <li>• të përkufizojë termin <i>zhvillim i qëndrueshëm</i>;</li> <li>• të përshkruajë me fjalët e tij përmbajtjen e ligjeve kryesore për mbrojtjen e mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.</li> </ul>
9	Shëndeti	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të japë një përkufizim për shëndetin;</li> <li>• të rendisë rreziqet kryesore që kërcënojnë shëndetin;</li> <li>• të shpjegojë rëndësinë e informacionit dhe të parandalimit për mbrojtjen e shëndetit;</li> <li>• të përshkruajë dëmet që shkaktojnë disa prej armiqve të shëndetit, si: droga, alkooli, duhani etj.;</li> <li>• të argumentojë, bazuar në ligjin shqiptar, rëndësinë e luftës kundër këtyre armiqve të shëndetit.</li> </ul>
10	Ushqimi	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë ç’do të thotë të ushqehesh;</li> <li>• të përdorë, duke u mbështetur edhe në njohuritë e</li> </ul>

		<p>marra nga lëndët e tjera (biologji, kimi) konceptet kryesore fiziologjike, që lidhen me të ushqyerit, për përshkrimin ose argumentimin e qëndrimeve të ndryshme qytetare;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të rendisë disa nga ushqimet më të shëndetshme mbi bazën e kriterëve shkencore;</li> <li>• të shpjegojë rëndësinë e të ushqyerit në mënyrë të baraspeshuar;</li> <li>• të përshkruajë disa nga sëmundjet që lidhen me qëndrimin ndaj të ushqyerit;</li> <li>• të dallojë ushqimet natyrore e të shëndetshme nga ato të ndryshuara;</li> <li>• të përdorë ligjin shqiptar që mbron të drejtat e individit në fushën e ushqimit, për të mbrojtur veten dhe të tjerët nga ushqimet e ndryshuara.</li> </ul>	
11	Konsumatori	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përcaktojë përmbajtjen e konceptit konsumator dhe të përshkruajë të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit;</li> <li>• të përshkruajë disa nga faktorët që ndikojnë në sjelljet e konsumatorit;</li> <li>• të përshkruajë dhe të analizojë elementet kryesore të kontratës së shitblerjes;</li> <li>• të shpjegojë elementet dhe rëndësinë e garancisë për respektimin e të drejtave dhe të detyrimeve të konsumatorit;</li> <li>• të përshkruajë funksionet e reklamës dhe të analizojë raste të keqpërdorimit të saj, si shkelje të interesave dhe të të drejtave të konsumatorit.</li> </ul>	
12	Siguria	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p>	

	rrugore	<ul style="list-style-type: none"> <li>të dallojë sinjalet kryesore rrugore që rregullojnë qarkullimin e këmbësorëve, të biçikletave, të motoçikletave dhe të automjeteve;</li> <li>të marrë vendim për lëvizjen e tij në rrugë në përputhje me rregullat e qarkullimit rrugor.</li> </ul>	
13	Informimi	<p><b>Mësuesi të jetë i aftë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të përcaktojë konceptin <i>informacion</i>;</li> <li>të përshkruajë mjetet kryesore tradicionale dhe të reja të informacionit;</li> <li>të rendisë mundësitë dhe kufizimet e informacionit;</li> <li>të vlerësojë ligjin shqiptar të medias.</li> </ul>	

### 3.1.1 Model testi

#### DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR

- Bazuar në “Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, një nxënës që ndjek klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë, ka munguar 30% të orëve vjetore lëndore. Në një rast të tillë, nxënësi **1 pikë**

A) vlerësohet me shkrim nga një komision që ngre drejtoria e institucionit arsimor.  
 B) vlerësohet me shkrim nga mësuesi i lëndës për njohuritë dhe konceptet, në të cilat ka munguar.  
 C) nuk klasifikohet në atë lëndë.  
 D) mbetet në klasë dhe përsërit vitin shkollor.
- Bazuar në standardet e formimit të përgjithshëm të mësuesit në arsimin parauniversitar, një mësues analizoi të gjithë treguesit e standardit “Vlerësimi i të nxënësve”. Nga vetëvlerësimi i treguesve të këtij standardi, i rezultoi që mesatarja e pikëve për këtë standard ishte 3,6. Përcaktoni nivelin e arritjes së këtij standardi që korrespondon me këtë mesatare të pikëve: **1 pikë**

A) Niveli 1

- B) Niveli 2
- C) Niveli 3
- D) Niveli 4

3. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) në lidhje me kriteret që duhet të plotësojë mësuesi që zgjidhet kryetar i ekipit lëndor:

**2 pikë**

- a. Të ketë punuar të paktën 10 vjet si mësues në po atë nivel arsimor. \_\_\_\_\_
- b. Të jetë vlerësuar me të paktën “Shumë mirë” në provimin e kualifikimit, nëse e ka dhënë provimin. \_\_\_\_\_

**PROGRAMI LËNDOR**

4. Kurrikula në bazë shkolle synon kryesisht:

**1 pikë**

- A. të unifikojë arsimin në nivel kombëtar.
- B. të vendosë kritere për të matur arritjet e nxënësve në nivel vendor.
- C. t’u ofrojë nxënësve mundësinë për të përfituar përvoja të reja arsimore.
- D. të pajisë nxënësit me aftësitë e nevojshme për punësim në nivel vendor.

5. Zgjidhni e vërtetë (V) apo e Gabuar (G) në lidhje me pohimin e mëposhtëm.

**1 pikë**

Kurrikula e lëndëve shoqërore synon të sigurojë dhe të forcojë tek nxënësit bindjen ndaj politikave të shtetit demokratik\_\_\_\_\_

6. Rezultati i pritshëm i të mësuarit “Nxënësi përshkruan marrëdhëniet ndërmjet edukimit për median dhe informimin, qytetarisë dhe demokracisë” lidhet me njëren prej kompetencave të mëposhtme. Rezultati i pritshëm i mësipërm, lidhet më shumë me:

**1 pikë**

- A. të kuptuarit e rolit të medias dhe të informacionit në demokraci.
- B. të kuptuarit e përmbajtjes së medias dhe të përdorimit të saj.
- C. sigurimin me cilësi dhe rendiment të informacionit.
- D. vlerësimi kritik i informacionit dhe i burimeve të tij.

7. Plotësoni vendet bosh me fjalën ose togfjalëshin e duhur.

Për të hartuar kurrikulën në bazë shkolle mësuesi duhet të dijë:

**3 pikë**

A. kërkesat që ushtron ndaj ..... mjedisi vendor	A. arritjet e nxënësve
B. .... dhe prejardhjen e nxënëse	B. shkollës

C. .... në nivel vëndor	C. njohuritë
----------------------------	--------------

### ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

8. Lidhur me kompetencën e mësuesit për të zotëruar përmbajtjen e materialit mësimor, ka më shumë nevojë për trajnim mësuesi që:

1 pikë

- A. mbështetet tek teksti mësimor dhe udhëzuesi i mësuesit për të zhvilluar mësimin.
- B. është në dijeni të zhvillimeve dhe të materialeve të reja që lidhen me lëndën .
- C. paraqet gjithnjë informacion të besueshëm dhe që lidhet me lëndën dhe me temën konkrete që trajton.
- D. asnjë nga të mësipërmet.

9. Ju, si mësues keni vendosur të përdorni **median** në një orë mësimore për të rritur vetëdijen e nxënësve tuaj, jo vetëm për mundësitë që ofron media në fushën e edukimit, por edhe për rreziqet që bart. Shkruani 3 objektiva të mësuarit (pritshmëri në tre nivele arritjeje) që ju synoni të arrini përmes një orë mësimore

3 pikë

Në fund të orës mësimore, pritet që nxënësit të jenë të aftë:

- a. \_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_
- c. \_\_\_\_\_

10. Për të shmangur konfliktet ndërmjet mësuesve dhe nxënësve në fushën e vlerësimit mësuesi duhet:

1 pikë

- A. të bindë nxënësit në drejtësinë e vendimit të tij.
- B. të mos lejojë diskutime me nxënësit për notën e vënë.
- C. të bëjë të qarta që në fillim kriteret e vlerësimit të nxënësve.
- D. të rishikojë vendimin e tij.

11. **Përshkruani fillimisht, çfarë duhet jetë i aftë të bëjë një nxënës në një temë të caktuar mësimore dhe pastaj përcaktoni rezultatet e pritshme të të mësuarit në tre nivelet e arritjeve sipas skemës së mëposhtme:**

4 pikë

Rezultati i pritshëm i të nxënësit sipas temës mësimore ose kurrikulës së lëndës:

“Nxënësit, në fund të orës së mësimit, duhet të jenë të aftë të .....

.....

..

Rezultatet e pritshme të të mësuarit në tri nivele

Në fund të orës së mësimit, pas përpjekjeve të përbashkëta, nxënësit do të jenë të aftë:

Niveli i ulët	Niveli mesatar	Niveli i lartë
Të ....	Të .....	Të .....

12. Për të parandaluar ose për të pakësuar në mënyrë të efektshme paragjykimet në klasën e tyre, mësuesit:

4 pikë

- Duhet të jenë model i sjelljeve dhe qëndrimeve pa paragjykime \_\_\_\_.
- Duhet t'i kushtojnë për një kohë të caktuar trajtimit të çështjeve të pakicave \_\_\_\_.
- Duhet të dënojnë fëmijët që shfaqin paragjykime \_\_\_\_.
- Duhet të shpërfillin si të parëndësishme shprehjet e paragjykimeve dhe të njëanshmërive në klasë \_\_\_\_.

### ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS

13. Në një klasë ku ka nxënës me vështirësi në të nxënë, mësuesi:

1 pikë

- vendos të njëjtat rezultate të nxëni për të gjithë nxënësit e klasës, por realizon punë të diferencuar me nxënës të ndryshëm.
- përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel më të ulët arritjesh.
- vendos rezultate të nxëni të ndryshme për nxënës të ndryshëm.
- përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel të lartë arritjesh.

14. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) për treguesit e parimit të përkushtimit ndaj komunitetit të përcaktuara në Kodin e etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar:

2 pikë

- Mësuesi jeton në komunitet dhe për të. Ai ka në qendër të interesit të tij kthimin e shkollës, gjithnjë e më shumë, në qendër komunitare. \_\_\_\_
- Mësuesi pranon që trashëgimia gjuhësore dhe kulturore, familja dhe komuniteti nuk modelojnë marrëdhëniet e shkollës me komunitetin. \_\_\_\_

### ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

15. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) viti 11-të i shkollës
- B) viti i 11 i shkollës
- C) viti i 11-t i shkollës
- D) viti i 11-të i shkollës

1 pikë

16. Përcaktoni nëse janë shkruar saktë (S) ose gabim (G), shprehjet e mëposhtme.

- a) livadhe të gjelbër\_\_\_\_
- b) atllas gjeografik\_\_\_\_
- c) Instituti i Shëndetit Publik\_\_\_\_

3 pikë

### **PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS**

17. Ndryshimet në kushtetutë ndodhin si pasojë e ndryshimeve në jetën e shoqërisë. Këto ndryshime lidhen me:

- A) cilësinë dhe sasinë e neneve të ndryshuara.
- B) sasinë e ndryshimeve kushtetuese.
- C) cilësinë e përmbajtjes së saj që nuk i përgjigjet realitetit.
- D) ndryshimet e ligjeve të tjera që burojnë nga kushtetuta.

1 pikë

18. Në Kushtetutën e RSH shpallet se partitë politike dhe organizata të tjera, programet dhe veprimtaritë e të cilave mbështeten në metoda totalitariste janë të ndaluara sipas ligjit. Kjo lidhet me parimin e:

- A) Ndarjes së pushteteve
- B) Kushtetutshmërisë
- C) Pluralizmit
- D) Sovranitetit

1 pikë

19. Neni 10 në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë përcakton se nuk ka fe zyrtare. Kjo do të thotë se:

- A) shteti i shpall bashkësitë fetare persona fizikë;
- B) shteti nuk trajton me përparësi një fe të veçantë;
- C) secili duhet të besojë një fe të caktuar;
- D) secili duhet të besojë disa fe njëherësh.

1 pikë

20. Veprimi i ligjit në hapësirë nënkupton që zbatimi i tij:

- A. ndryshon në varësi të veçorive psikologjike të një krahine.

1 pikë

- B. ndryshon brenda kufijve të territorit të qarkut.
- C. ka fuqi brenda territorit të shtetit.
- D. nuk ndryshon asnjëherë brenda hapësirës ku vepron.

21. Në fillimet e viteve '90 në Shqipëri nuk kishte ligj që të ndalonte kultivimin dhe tregtimin e lëndëve narkotike. Ky fakt u shfrytëzua për aktivitete ekonomike që bazoheshin në kultivimin e lëndëve narkotike, pasi, për rrjedhojë nuk ekzistonin as dënime. Kjo situatë lidhet më shumë me:

- A) lidhjen e ligjit me realitetin.
- B) pakujdesinë e organeve ligjvënëse.
- C) interesat e ekonomike të grupimeve të caktuara.
- D) mungesën e specialistëve të fushës ligjore.

1 pikë

22. Protesta paqësore e një force politike në një shesh publik, shpesh herë degradon në dhunë ndaj policisë dhe objekteve me rëndësi sociale. Konflikti ndërmjet protestuesve dhe policisë, në thelb lidhet edhe me një konflikt të drejtash. Konkretisht, ai lidhet me konfliktin ndërmjet:

1 pikë

23. Të drejtës për protestë paqësore dhe të drejtës për të pasur një rend dhe qetësi publike.

24. Të drejtës për të manifestuar në mënyrë paqësore dhe të drejtës për të qarkulluar me automjete.

25. Të drejtës për grumbullime paqësore dhe të drejtës për të mbrojtur pronën private.

26. Të drejtës së lëvizjes dhe të drejtës për të përdorur një mjedis publike që e kufizon këtë lëvizje.

27. Një nxënës qëndron i ulur në klasë me shikimin nga dritarja. Duket se fjalët e mësueses nuk i ngjallin asnjë interes. Po kështu edhe diskutimet e shokëve. Në këtë rast kemi të bëjmë me:

1 pikë

- A) mosgjatjen nga mësuesi të metodës së duhur për nxënësin.
- B) dukurinë e braktisjes së fshehtë të mësimin nga nxënësi.
- C) mungesën e raporteve shoqërore me të tjerët.
- D) shpërfilljen e nxënësit nga mësuesi.

28. Nuk është një parim mbi të cilin mbështetet reforma në arsimin e mesëm në vendin tonë:

- A) Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës.
- B) Arsimi me në qendër mësuesin.
- C) Arsimi i mesëm i njësuar.
- D) Sigurimi i cilësisë së arritjeve sipas standardeve.

1 pikë



29. Ligji për median:

1 pikë

- A) e kufizon të drejtën e saj për të informuar publikun;
- B) e ruan atë nga pushteti politik;
- C) rrit mundësinë e abuzimit të saj;
- D) rrit të drejtën e saj për të ndërhyrë në jetën private.

30. Për t'u përdorur për rubrikën "lajm", informacionet duhet të jenë:

1 pikë

- A) të njohura më parë, që të kuptohen nga publiku i thjeshtë;
- B) të palidhura me jetën e publikut, se çënon privatësinë e tij;
- C) të palidhura me fatet e njerëzve, se prek të drejtat e tyre;
- D) të reja dhe të lidhura me jetën e publikut.

31. Në një biznes privat, pronari u ndëshkua sepse në biznesin e tij u gjetën tre punonjës pa kontratë pune, në të cilën do të pasqyrohej edhe paga dhe koha e punës. Kjo parregullsi lidhet me:

1 pikë

- A) mungesën e informimit nga punonjësit.
- B) punën e paligjshme.
- C) vepër që ndëshkohet nga kodi penal.
- D) shkelje e kodit të punës.

32. Në median televizive shfaqet rasti i një fëmije të dhunuar i cili ishte nxënës në një shkollë 9 vjeçare. Në etikën mediatike ka shumë rëndësi identiteti i fëmijës, prandaj media duhet t'i kushtojë vëmendje:

1 pikë

- A) ngjarjes dhe rëndësisë për t'u njohur nga publiku;
- B) analizës së shkaqeve pa dhënë detaje të veprës;
- C) identitetit të fëmijës, fshehtësisë në foto, pamje etj.;
- D) të gjitha alternativat.

33. Para disa vitesh, një nga partitë tona kryesore, në pozicionin e opozitës, kërkoi të zhvillojë një manifestim paqësor në sheshin kryesor të pushtetit. Për këtë, ajo bëri kërkesë, sipas ligjit, në organet përgjegjëse. Organet e rendit nuk dhanë leje për këtë manifestim, me argumentin se ai do të shkaktonte pakënaqësinë e shumicës. Nëse çështja do të shkonte në gjykatë. Tregoni që:

3 pikë

a) çështja konkrete lidhet me

\_\_\_\_\_

b) liria për tubim paqësor detyron shtetin të

\_\_\_\_\_

c) të garantosh të drejtën për tubime paqësore dhe të pjesëmarrjes në to, do të thotë që shteti

---

34. Përshkruani thelbin e parimit kushtetues për:

3 pikë

a) zgjedhje të lira

---

b) zgjedhje të barabarta

---

c) zgjedhje periodike

---

35. Një shërbim shëndetësor publik cilësor, synon disa objektiva. Evidentoni:

3 pikë

a) dy objektiva (ose fusha veprimi) për institucionet shëndetësore për rritjen e cilësisë së shërbimit

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

b) një objektiv për profesionalizmin e stafit të shërbimit shëndetësor

- \_\_\_\_\_

36. Një mësues, në zbatim të objektivave të orës së mësimit, u lexon nxënësve një lajm të marrë nga media e huaj, sipas të cilit, një i ri, i pajisur me armë, hap zjarr në një kamp rinor që ndodhet në një vend të Evropës dhe shkakton rreth 80 të vdekur. Më pas, u kërkon atyre të hamendësojnë për personin që kreu këtë akt. Ai i ndihmon nxënësit me pyetjet e mëposhtme:

- Cili mund të jetë personi që kreu këtë veprim?
- Cilat mund të kenë qenë shkaqet e mundshme të tij?
- Si i argumentoni hamendësimet tuaja?

Duke u bazuar në situatën mësimore të ndërtuar nga mësuesi, hamendësoni **dy aftësi dhe dy karakteristika të të menduarit të nxënësve** të cilat mësuesi i ka pasur në mendje për t'i edukuar tek nxënësi kur ka përzgjedhur rezultatet e të pritshme të mësuarit që mund të ketë planifikuar mësuesi në ditarin e tij për këtë orë mësimi.

4 pikë

Aftësi intelektuale

Karakteristika të të menduarit

1. Aftësia për të \_\_\_\_\_

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

2. Aftësia për të \_\_\_\_\_

37. Shpjegoni mekanizmin që garanton funksionin parandalues të ligjit. Dalloni të paktën dy aspekte.

**2 pikë**

a. \_\_\_\_\_

b. \_\_\_\_\_

38. Shpesh herë në media nga goja e personaliteteve të saj dhe të politikës, dëgjojmë të akuzohen individë, politikanë, etj., për kryerjen e veprave penale për të cilat edhe duhet të dënohen sipas ligjit. Ligji për mediat e ruan atë, median, nga abuzimet duke përcaktuar që:

**3 pikë**

a) medias nuk i lejohe të \_\_\_\_\_

b) media duhet të respektojë \_\_\_\_\_

c) media duhet të respektojë të drejtat e njeriut, duke \_\_\_\_\_

39. Ajo që vihet re jo rrallë në procesin e hartimit të ligjeve ose të akteve nënligjore në Shqipëri është fakti që, pak kohë pas miratimit të ligjit dhe zbatimit të tij në praktikë, lind nevoja e rishikimit të tij. Renditni tri arsye përse ndodh kjo dukuri dhe analizojeni atë.

**3 pikë**

c. \_\_\_\_\_

d. \_\_\_\_\_

e. \_\_\_\_\_

**E vërtetë (V) apo e gabuar (G)**

40. \_\_\_\_\_ Ligji për median synon të kufizojë të drejtën e saj për të informuar publikun \_\_\_\_\_

**1 pikë**

41. Fakti që në Shqipëri nuk ka fe zyrtare, tregon shpërfilljen e shtetit ndaj detyrimit për t'i respektuar fetë e ndryshme \_\_\_\_\_

**1 pikë**

42. Protokollin në situatën e pandemisë nga Covid 19, përmban rregulla për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së qytetarëve. Ky ligj nënkupton përgjegjësinë e shtetit për të drejtën e shëndetit\_\_\_\_\_

**1 pikë**

43. Administratori i banesës në bashkëpronësi ka të drejtë të shmangë vendimet e Asamblesë së bashkëpronarëve \_\_\_\_\_.

**1 pikë**

44. Ajo që vihet re jo rrallë në procesin e hartimit të ligjeve ose të akteve nënligjore në Shqipëri është fakti që, pak kohë pas miratimit të ligjit dhe zbatimit të tij në praktikë, lind nevoja e rishikimit të tij. Arsyeja qëndron në ndryshimin shumë të shpejtë të realitetit shqiptar në të gjitha fushat e tij \_\_\_\_\_.

**1 pikë**

45. Veprimi i ligjit në hapësirë nënkupton që zbatimi i tij varet nga veçoritë e zonës ku do të zbatohet \_\_\_\_ .

**1 pikë**

Plotësoni

46. Kodi i punës është një përmbledhje rregullash dhe normash ligjore që rregullojnë

**1 pikë**

---

### ***3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit***

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshiaten me stilet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirëmenduar dhe e mirë planifikuar, si dhe një mjedis të nxënësve krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësve. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Programi orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit përmban model ore mësimore për AMU-në dhe për AML-n si dhe kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur.

#### ***3.2.1 Modele orësh mësimore për lëndët sociale***

Për të orientuar mësuesit që do të zhvillojnë orën mësimore të hapur për kategorinë e parë të kualifikimit, më poshtë është dhënë një model ore mësimore për secilin nivel arsimor: AMU dhe AML. *Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënësve, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.*



## Veprimtari 1

**Tema: Ndal është jeta ime.**

### Qëllimi

Kjo veprimtari mund të zhvillohet në kuadrin e një ore që mund të ketë si objektiv trajtimin e ndryshimeve kulturore dhe subkulturore të njerëzve dhe rëndësisë së njohjes, të vlerësimit dhe të respektimit të tyre për përmirësimin e cilësisë së marrëdhënieve shoqërore në përgjithësi dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në veçanti. Po kështu, kjo veprimtari krijon mundësi për trajtimin e rëndësisë që ka njohja e veçorive të secilit për parandalimin ose zgjidhjen e konflikteve.

Përveç kësaj kjo veprimtari është edhe një shembull i përdorimit të llojeve të ndryshme të objektivave në fushën e edukimit të të drejtave të njeriut të trajtuar më sipër.

Kjo veprimtari synon:

- ☞ të ndihmojë nxënësit të kuptojnë rëndësinë e njohjes së karakteristikave të tjetrit:
  - për krijimin e harmonisë në marrëdhëniet shoqërore,
  - për parandalimin e konflikteve që lidhen me mosrespektimin e veçorive të secilit,
  - për të ndihmuar të tjerët në raste fatkeqësish, traumash, apo vështirësish të natyrave të ndryshme,
- ☞ të aftësojë nxënësit të marrin parasysh veçoritë individuale dhe ato të jetës private në komunikimin e tyre të përditshëm në shoqëri.

### Rezultatet e pritshme të të mësuarit:

Në fund të këtij aktivitetit nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë mes të drejtave të shumta , të drejtën për një jetë private pa ndërhyrje nga të tjerët (*njohja*),
- të lidhë standardin me kontekstin social dhe kulturor psikologjik të individit(*kontekstualizimi*),
- të tregojë, përmes vendimmarrjes, rëndësinë e respektimit të jetës private të tij dhe të të tjerëve, duke marrë parasysh kulturën, zakonet, traditat etj. (zbatimi)

**Koha: 45'**

### Zhvillimi i veprimtarisë

### Hapi i parë

Mësuesi u jep nxënësve situatën e mëposhtme:

Mendoni veten në rolin e një gazetari që cili kërkon të intervistojë tri personazhe femra për jetën e tyre private. Personazhet ndodhen:

- Në Shqipëri
- Në SHBA
- Në Filipine

Mësuesi u kërkon nxënësve të shkruajnë tri pyetje që do ua drejtojnë personazheve në fjalë. Pasi secili nxënës shkruan pyetjet në një letër, ata e kthejnë letrën përmbys.

### Hapi i dytë

Në këtë fazë mësuesi kërkon nga nxënësit të mendojnë në mënyrë individuale dhe më pas të radhitin në një fletë të bardhë:

- 3 gjëra që *lehtësisht* do t'i bisedonin me të tjerët;
- 3 gjëra që me *vështirësi* do t'i bisedonin me të tjerët;
- 3 gjëra të cilat nuk do të dëshironin t'i bisedonin me të tjerët, duke iu quajtur vatëate.

### Hapi i tretë

Pas kësaj klasi ndahet në grupe dhe secilit grup i kërkohet të diskutojë e të marrë vendim për të bërë ndarjen e mësipërme.

Pasi nxënësit të kenë realizuar detyrën, mësuesi ndërton, në tabelë ose në një tabak të madh letre kolonat e mëposhtme:

Të thjeshta për t'i diskutuar me të tjerët	Të vështira për t'i diskutuar me të tjerët	Private

Më pas ai dëgjon raportimet e grupeve dhe bën plotësimet sipas kolonës.

### Hapi i katërt

Mësuesi dialogon me nxënësit duke u drejtuar atyre pyetjet e mëposhtme:

- *Përse disa gjëra diskutohen lehtë me të tjerët e të tjera jo?*
- *Cilat janë të përbashkëtat për secilën kategori në ndarjet tuaja?*
- *Si e shpjegoni faktin që të njëjtat gjëra i shohim në tituj të ndryshëm (një vajzë i tregon nënës, një tjetër jo)?*
- *A mund të ketë një ndarje fikse në qëndrimet e njerëzve për të njëjtat gjëra? Pse ekzistojnë konceptime të ndryshme për gjërat private? Cilët janë faktorët që ndikojnë në të?*



- *A ndikon kjo edhe në mënyrën se si njerëz të ndryshëm përjetojnë situata të njëjta ose të ngjashme?*

Gjatë diskutimit mësuesi e përqendron vëmendjen e nxënësve te rëndësia që ka respektimi i individualitetit të secilit kur bëhet fjalë për çështje që prekin ndjenjat, hapësirat e jetës private të njerëzve të cilat siç e pamë lidhen ngushtë me prejardhjen e tij psiko-kulturore, familjare, me statusin e tij social etj.

### **Hapi i pestë**

*Reflektim.*

Në këtë fazë, mësuesi fton nxënësit një proces reflektimi duke zhvilluar pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë të drejtat e njeriut që përfshihen në këtë rast studimor?
- Si e kuptoni ju të drejtën për një jetë private?
- Nga varet realizimi i të drejtës për një jetë private? Çfarë e rrezikon atë?
- Nëse ekzistojnë kufij të respektimit të jetës private, në ç'raste duhet të vendosen ata (a mund të jenë kufijtë e njëjtë)?
- Cilat janë përfundimet që mund të nxirren nëse kjo çështje trajtohet?
  - Si çështje ligjore
  - Si çështje kulturore
  - Si çështje që lidhet me parandalimin e konfliktit etj.

Në fund mësuesi fton nxënësit të lexojnë pyetjet që bënë në fillim të orës së mësimi dhe u drejton atyre pyetjen:

A do të shkruanit të njëjtat pyetje pas kësaj ore mësimi? Përse?

A ka ndonjë nxënës që nuk i ka shkruar pyetjet menjëherë ose që ka kërkuar informacion shtesë...?

### **Vlerësimi**

Mësuesi vlerëson nxënësit në bazë të aftësisë së tyre:

- Për të dalluar, identifikuar mes të drejtave të shumta , të drejtën për një jetë private pa ndërhyrje nga të tjerët (*njohja*),
- Për të lidhë standardin (të drejtat dhe “kufijtë” ) që lidhen me kontekstin social dhe kulturor psikologjik të individit(*kontekstualizimi*),
- të tregojë rëndësinë e marrjes parasysh të kulturës të zakoneve, personalitetit etj, përpara se të marrin një vendim ose qëndrim që lidhet me respektimin e diversitetit etj. (zbatimi)

## Veprimtari 2

**Tema: Manipulimi i informacionit: Verifikoni dhe kushtojini rëndësi përpara se ta shpërndani**

### Qëllimi

Në këtë orë mësimore, nxënësit do të njihen me mundësinë e manipulimit të informacionit; me mundësinë e ndeshjes me informacionet e manipuluar dhe pasojat e mundshme që ato kanë në vendimmarrjet e tyre dhe të individëve në përgjithësi. Ata do të njihen me konceptet kryesore që lidhen me manipulimin e informacionit dhe format e shfaqjes së tyre në media.

Nxënësve u jepet mundësia të diskutojnë për pasojat e mundshme që ka manipulimi i informacionit për individin, grupin dhe shoqërinë dhe për këtë arsye, për rëndësinë që ka njohja dhe identifikimi i informacioneve manipuluese dhe i faktorëve që i krijojnë, i mbajnë gjallë dhe i përhapin dhe, për rrjedhojë, edhe për përgjegjësinë që duhet të ketë çdo individ që lufton për një shoqëri demokratike për ta identifikuar dhe ndaluar përhapjen e informacioneve manipuluese në të gjitha format e shfaqjes së tyre.

Suksesi i kësaj lufte varet jo vetëm nga njohja e dukurisë dhe e faktorëve që e krijojnë dhe e mbajnë gjallë, por edhe algoritmi, modeli e radha e veprimeve që duhet të ndjekë çdo individ në këtë drejtim.

Përveç kësaj, kjo veprimtari synon të sfidojë nxënësin si një krijues ose përhapës i mundshëm, me vetëdije ose jo, i informacioneve të manipuluar dhe i dialogut/reflektimeve që ai duhet të bëjë me veten përpara se kjo mundësi të kthehet në realitet.

### Rezultatet e pritshme të të mësuarit

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë përmbajtjen e konceptit manipulim i informacionit dhe i formave të shprehjes së tij;
- të përmendë disa nga faktorët që krijojnë ose mbajnë gjallë format e çrregullimit të informacionit, kushtet që krijojnë terrenin e përshtatshëm për këta faktorë dhe pasojat e tyre për individin, grupin dhe shoqërinë;
- të identifikojë disa nga hapat që ai duhet të ndërmarrë kur ndeshet me një informacion, si hapi i parë drejt krijimit të një algoritmi (modeli) të qëndrueshëm për t'u zbatuar në rastet kur përballlet me informacione të reja (ose edhe të vjetra, të para në kohë dhe hapësirë tjetër).

## Zhvillimi i veprimtarisë

### Hapi i parë 6-7 minuta

Mësuesi u kërkon nxënësve të kujtojnë raste kur janë ndeshur me informacione që më vonë kanë dalë të gabuara si dhe rastet kur ata kanë marrë vendime mbi bazën e këtyre informacioneve. Ai u kërkon atyre të thonë disa nga llojet e pasojave të këtyre vendimeve për ta (për veten, familjen, grupin ku bëjnë pjesë etj.) Mësuesi shënon në tabelë ose në dërrasën e zezë përgjigjet e nxënësve për pasojat e vendimeve.

Në vijim mësuesi kërkon prej nxënësve të përmendin disa nga burimet e këtyre informacioneve të gabuara për shembull nga lajmet, platformat sociale që përdorin etj.) dhe sa shpesh marrin vendime mbi bazën e informacioneve që marrin prej tyre. Mësuesi u kërkon nxënësve të përmendin edhe burime të tjera nga kanë marrë informacionet e gabuara në lagje, shkollë etj.

### Hapi i dytë 15 minuta

Mësuesi u paraqet nxënësve tabelën e mëposhtme dhe u shpjegon atyre përmbajtje e koncepte që përshkruhen aty.



Në vijim mësuesi i fton nxënësit të mendojnë për çështjet që lidhen me secilin prej koncepteve:

1. Keqinformim

- Si shprehen keqinformimet?
- Përse mund të ndodhin keqinformimet?
- Cilat janë disa nga pasojat e keqinformimit

2. Dezinformim

- Si shprehen keqinformimet?
- Cilat mund të jenë disa nga shkaqet që i krijojnë ose i mbajnë gjallë ato?
- Cilat janë disa nga pasojat e dezinformimit?

3. Informim keqdashës

- Si shprehen informacionet keqdashëse?
- Cilat janë disa nga shkaqet e mundshme që i krijojnë ose i mbajnë gjallë ato?
- Cilat janë disa nga pasojat e informimit keqdashës?

Mësuesi shënon në tabelë pasojat e mundshme për secilin rast.

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjen e mëposhtme dhe, për disa minuta, nxit diskutimin e klasës rreth saj?

- Çfarë duhet të bëjmë për të mos qenë viktime të manipulimit të informacionit?

**Hapi i tretë 15-17 minuta**

Mësuesi ndan klasën në grupe. Secili grup i jep detyrën të lexojnë një prej lajmeve në tabelën e mëposhtme.

Më tej ai kërkon prej tyre të verifikojnë lajmin duke u përgjigjur pyetjeve që ndodhen në tabelën e verifikimit të

## informacionit

Pyetje për verifikimin e informacionit	
1	Kush e ka krijuar mesazhin?
	A është ky burim i besueshëm?
2	Si përpiqet mesazhi ta mbërthejë vëmendjen time?
	A përdor germa shtypit?
	A përdor imazhe të forta?
3	Përse mendoni se është krijuar ky mesazh?
	Çfarë lloj veprimi mendoni se autori i mesazhit kërkon që ju të bëni pasi ta lexoni atë?
4	Kur u publikua mesazhi?
	A e ka datën?
	A ka datë të gabuar?
	A ka datë të vjetër?
5	Si u ndjetë nga ky mesazh?
	A mendoni se edhe të tjerët mund të kenë të njëjtat ndjesi si ju?

**TV Apollon**  
22 mins

Kura për virusin C19 ose mënyra për ta eliminuar atë. Informacioni vjen nga Izraeli atje ky virus nuk shkaktoi vdekje.  
\*Receta është e thjeshtë\*

1. "Limon"
2. "Bikarbonat"

Përziejini dhe pijeni si çaj të nxehtë - çdo pasdite, veprimi i limonit me sodë buke më të nxehtë - menjëherë shkatëron virusin - e eliminon plotësisht atë nga trupi. Këto dy përbërës alkalizojnë sistemin imunitar, pasi kur bie nata sistemi bëhet acid dhe mbrojtjet më të ulëta. Kjo është arsyeja pse populli i Izraelit është i qetë për këtë virus. Të gjithë në Izrael pinë një filxhan me ujë të nxehtë me limon dhe pak sodë buke gjatë natës, pasi kjo vërtetohet se vret virusin. Ndaje me të gjithë familjen dhe miqtë e tu, në mënyrë që askush prej nesh të mos marrë virusin.  
\*Ju lutemi shpërndajeni këtë menjëherë\*

**fakt.ai**  
1 hr

Kura për virusin C19 ose mënyra për ta eliminuar atë. Informacioni vjen nga Izraeli atje ky virus nuk shkaktoi vdekje.  
\*Receta është e thjeshtë\*

1. "Limon"
2. "Bikarbonat"

Përziejini dhe pijeni si çaj të nxehtë - çdo pasdite, veprimi i limonit me sodë buke më të nxehtë - menjëherë shkatëron virusin - e eliminon plotësisht atë nga trupi. Këto dy përbërës alkalizojnë sistemin imunitar, pasi kur bie nata sistemi bëhet acid dhe mbrojtjet më të ulëta. Kjo është arsyeja pse populli i Izraelit është i qetë për këtë virus. Të gjithë në Izrael pinë një filxhan me ujë të nxehtë me limon dhe pak sodë buke gjatë natës, pasi kjo vërtetohet se vret virusin. Ndaje me të gjithë familjen dhe miqtë e tu, në mënyrë që askush prej nesh të mos marrë virusin.  
\*Ju lutemi shpërndajeni këtë menjëherë\*

**Infiermiera shqiptare**  
2 hrs

Kura për virusin C19 ose mënyra për ta eliminuar atë. Informacioni vjen nga Izraeli atje ky virus nuk shkaktoi vdekje.  
\*Receta është e thjeshtë\*

1. "Limon"
2. "Bikarbonat"

Përziejini dhe pijeni si çaj të nxehtë - çdo pasdite, veprimi i limonit me sodë buke më të nxehtë - menjëherë shkatëron virusin - e eliminon plotësisht atë nga trupi. Këto dy përbërës alkalizojnë sistemin imunitar, pasi kur bie nata sistemi bëhet acid dhe mbrojtjet më të ulëta. Kjo është arsyeja pse populli i Izraelit është i qetë për këtë virus. Të gjithë në Izrael pinë një filxhan me ujë të nxehtë me limon dhe pak sodë buke gjatë natës, pasi kjo vërtetohet se vret virusin. Ndaje me të gjithë familjen dhe miqtë e tu, në mënyrë që askush prej nesh të mos marrë virusin.  
\*Ju lutemi shpërndajeni këtë menjëherë\*

**Eduart Ndoci** is with Eduart Ndoci and 9 others.  
1 hr

**NE ISRAEL BKA VDEKJE NGA C-19!**  
Një super lajm ... Kështu mbërti dhe kështu po dërgoj meqesi , nga një mik nga Ambasada Amerikane ne Tiranë.  
Theshtë arituri kurimi për virusin C19 ose mënyra për ta eliminuar atë. Informacioni vjen nga Izraeli atje ky virus nuk shkaktoi vdekje.  
\* Receta është e thjeshtë \*

1. "Limon"
2. "Bikarbonat"

Përziejini dhe pijeni si çaj të nxehtë - çdo pasdite, veprimi i limonit me sodë buke më të nxehtë - menjëherë shkatëron virusin - e eliminon plotësisht atë nga trupi. Këto dy përbërës alkalizojnë sistemin imunitar, pasi që kur bie nata sistemi bëhet acid dhe mbrojtjet më të ulëta. Kjo është arsyeja pse Populli i Izraelit është i qetë për këtë virus. Të gjithë në Izrael pinë një filxhan me ujë të nxehtë me limon dhe pak sodë buke gjatë natës, pasi kjo vërtetohet se vret virusin.  
E ndaj me të gjithë familjen dhe miqtë e mi, në mënyrë që askush prej nesh të mos marrë virusin. Unë e le atë në kriteret tuaja  
\* Ju lutem kalojeni këtë menjëherë \*

Në fund grupet ndajnë përfundimet e tyre.

## Reflektim 5 minuta

Mësuesi fton nxënësit të diskutojnë për:

1. Përgjegjësinë e çdo individi për të përcjellë gjithmonë informacione të vërteta.
2. Përgjegjësinë e çdo individi që të aftësohet përmes shkollës që të dallojë gjithmonë çrregullimet e informacionit.
3. Përgjegjësinë e çdo individi që të përdorë hapat e verifikimit të informacionit sa herë që ndeshet me të.

Vlerësimi i nxënësit bëhet duke u bazuar në shkallën e përmbushjes së rezultateve të pritshme të të mësuarit

### **Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur**

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:

- mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

### **Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur**

<b>Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur</b>				
<b>Gjithsej 70 pikë</b>				
<b>Përshkruesit</b>	<b>Niveli 1 - Dobët</b>	<b>Niveli 2 – Mjaftueshëm</b>	<b>Niveli 3 – Mirë</b>	<b>Niveli 4 – Shumë mirë</b>
<b>Planifikimi i orës mësimore të hapur (10 pikë)</b>				
<b>Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënësve</b>	<b>0 – 1 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar orën mësimore pa pasur një koherencë të komponentëve. Rezultatet e të nxënësve (RN) nuk bazohen në programin lëndor dhe mësuesi nuk ka planifikuar situatë të nxënësve. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënësve. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.	<b>2 – 3 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënësve, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënësve (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxënësve. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënësve, Pyetjet në përgjithësi janë	<b>4 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësve, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodat dhe teknikat mësimore janë në një koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënësve dhe me stilet e të nxënësve. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.	<b>5 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësve të cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënësve, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.

		<i>sipas niveleve.</i>		
<b>Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënësve gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi ka një planifikim ditor rutinë, pa u kujdesur për qasje të reja inovative dhe pa përfshirë edhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i>	4 pikë <i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i>	5 pikë <i>Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i>

**Mjedisi i të nxënësve (14 pikë)**

<b>Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimi vetëm disa nxënës ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	4 - 5 pikë <i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i>	6 - 7 pikë <i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i>
<b>Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi organizon orën e mësimi në</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi organizon orën e mësimi në</i>	4 - 5 pikë <i>Mësuesi organizon orën e mësimi duke</i>	6 - 7 pikë <i>Mësuesi organizon orën e mësimi duke</i>



<p><b>nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes</b></p>	<p><i>mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimi.</i></p>	<p><i>mënyrë tradicionale, ku jo gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i></p>	<p><i>u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasiv.. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i></p>	<p><i>u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i></p>
--	---	---	---	--

**Metodat mësimore (21 pikë)**

<p><b>Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodave që do të përdorë dhe stilet e të nxënësve</b></p>	<p><i>0 – 1 pikë Mësuesi nuk organizon nxënësit në varësi të metodës së zgjedhur dhe demonstroi që nuk i njej stilet e të nxënësve. Ora e mësimi është rutinë dhe kryesisht tradicionale.</i></p>	<p><i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që i njej stilet e të nxënësve të tij por ora e mësimi është tradicionale pa u kujdesur që nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre bazuar në stilin e tyre të të nxënësve.</i></p>	<p><i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që i njej stilet e të nxënësve të tij por metodat e teknikat që përdor në orën e mësimi nuk përfshijnë të gjitha stilet e të nxënësve duke krijuar kushte që jo të gjithë nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre.</i></p>	<p><i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që njej shumë mirë stilet e të nxënësve të tij dhe përdor metoda e teknika që i lidh më së miri me stilet e të nxënësve duke i dhënë mundësi nxënësve të përmirësojnë arritjet e tyre.</i></p>
<p><b>Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin)</b></p>	<p><i>0 – 1 pikë Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore mësimi</i></p>	<p><i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimi duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore vetëm</i></p>	<p><i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxit mendimin kritik, krijues të nxënësve, por vetëm disa</i></p>	<p><i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshmërinë e metodave të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësve, që nxisin</i></p>

	<i>fokusohehet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>	<i>nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>diskutimin (apo debatin) dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>
<b>Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit</b>	<i>0 – 1 pikë Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje.</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto pyetje gjatë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit dhe njëri – tjetrit.</i>

#### **Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë)**

<b>Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij</b>	<i>0 – 1 pikë Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit.</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit.</i>	<i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij.</i>	<i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.</i>
<b>Mësuesi përdor</b>	<i>0 – 1 pikë</i>	<i>2 – 3 pikë</i>	<i>4 pikë</i>	<i>5 pikë</i>

<b>teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes</b>	<i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi por nuk përdor nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>
<b>Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të nxënësve</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënësit apo nevojat e nxënësve.</i>	2 – 3 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	4 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon nxënësit me detyra të diferencuara bazuar në nevojat e tyre.</i>	5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të tyre.</i>
<b>Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (8 pikë)</b>				
<b>Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënësit të temës mësimore.</i>	2 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore.</i>	3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i>	4 pikë <i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxënësit të mësuarin praktik dhe krijues.</i>
<b>Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore,</i>	2 pikë <i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale por përmbajtja nuk lidhet shumë me rezultatet e të</i>	3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore, por nxënësit nuk</i>	4 pikë <i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në</i>

		<i>nxënit të temës mësimore.</i>	<i>angazhohen në përdorimin e TIK.</i>	<i>përbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>
--	--	--------------------------------------	--	---